

V E N D I M
Nr. 610, datë 12.11.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BULQIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Bulqizës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bulqizës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 3575 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 1 144 000 (një milion e njëqind e dyzet e katër mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit janë në ngarkim të Bashkisë së Bulqizës, kërkesit për shpronësim, në shumën 105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Paga e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Bulqizës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA BULQIZË**

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera lekë
1	Lime Ahmet Cupi	3575	320	1 144 000